



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0899

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Botek Sh.P.K” kundër Njoftimit për anulimin lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative” me nr. të prokurimit: "632-23-5132-5-5-8", inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, më 26/01/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “Botek Sh.P.K” me nr. 2023/0899 , e datës 13/11/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative” me nr. të prokurimit: "632-23-5132-5-5-8", inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës.

2. Mbetet në fuqi, vendimi i AK për anulim të aktivitetit të prokurimit i inicuar nga AK–Komuna e Gjakovës.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.05.2023, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative” me nr. të prokurimit: "632-23-5132-5-5-8". Ndërsa me datën 25.10.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar kontratë publike kornizë, procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim.

Me 26.10.2023, OE “Botek Sh.P.K” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 01.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për

rishqyrtim.

Me 13.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Botek Sh.P.K” me nr. 899/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative” me nr. të prokurimit: "632-23-5132-5-5-8".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Botek Sh.P.K”, janë parashtruar si në vijim:

Sqarim : “Përmes kësaj ankese, atakojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjakovës, mbi refuzimin e Kërkesës sonë për Rishqyrtim, të parashtruar me datë 26.10.2023 lidhur me Vendimin për Ri-Vlerësim/Anulim të aktivitetit të prokurimit. Në vijim po shtjellojmë në detaje shkeljet procedurale që ka bërë Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, duke vendosur për anulimin e procedurës së prokurimit, vendim i cili është plotësisht i paligjshëm dhe shkel të gjitha ligjet e rregulloret në fuqi (dhe tenton të shtrembërojë faktet aktuale për përfitime të ndonjë operatori ekonomik tjetër apo për përfitime personale të personave të tretë.) Në Vendim AK i referohet dy çështjeve si arsye për anulim: 1. Shkelja ligjore, që është e pamundur të evitohet në këtë fazë dhe 2. Respektimi i vendimit të OSHP-së nr. 2023/0482.”

Pretendimi i parë (I) : “Shkelje ligjore, që është e pamundur të evitohet në këtë fazë nuk vlen sepse: 1. Arsyetimi i AK se në FPO (DT) ka pasur lëshim sepse është kërkuar që: ”OE të ofrojnë vetëm deklaratë për specifikime teknike mirëpo nuk është kërkuar dëshmia për specifikimet teknike të detyruara të ofruara” nuk qëndron, për faktin se: Sipas LPP – Neni 20, RRPP – Pika 20 dhe Marrëveshjes Publike Kornizë (që është bazë e FPO), saktësohet qartë se OE pjesëmarrës në të gjitha aktivitetet e prokurimit, e veçanërisht e precizuar në FPO për këtë AP, duhet të dorëzojnë Specifikimin Teknik të produkteve të ofertuara. Pra, rrjedhimisht arsyetimi në vendimin tuaj është i pabazuar, pasi që specifikimi i detajuar teknik është obligativ përmes dispozitave të LPP-së, si dhe nga Marrëveshja Kornizë e nënshkruar nga secili OE, bazë për procedurat e mini tenderit.”

Pretendimi i dytë (II): ” Për më tepër, arsyetimi i mësipërm nuk qëndron sepse sipas FPO, neni IV, pika 6 – thuhet se Tenderi do të përbëhet nga dokumentet e plotësuar dhe të nënshkruara si në vijim: b. Deklarata mbi Specifikimet Teknike të objektit të ofruar të kontratës, që korrespondon me ato të përmendura në Aneksin 1 të FPO-së. Pra, kjo kërkesë në FPO nuk mund të jetë asnjë dokument tjetër përveç dokumentit të dorëzuar nga OE (deklaratë mbi specifikime

teknike) në të cilin duhet të jenë të detajuara specifikimet teknike të produkteve që ofertohej ose ndryshe sikurse AK ka shkruar në vendimin e tyre “Dëshmia për specifikimet teknike të detyruara të ofruara”. Pikërisht kjo dëshmi/dokument/deklaratë është e paraparë me Marrëveshjen Publike Kornizë, në të cilën ndër të tjera kërkohet që OE: “Për secilin produkt duhet të specifikoni emrin e modelit që e ofertoni.”

Pretendimi i tretë (III):” . Tutje, sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, pika 10 – Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve – Nëse Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (“specifikimit teknik” – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç në rastet kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do të jene në përputhje me specifikimin e kërkuar), atëherë AK duhet të veproj duke Refuzuar tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm, bazuar në nenin 28 të LPP. Prova 2. Pra, sipas udhëzuesit, OE gjithmonë duhet të dorëzojnë specifikimin e detajuar të pajisjeve të ofruara në rastin e procedurave që kanë objekt të kontratës pajisje sikur edhe kjo procedurë, pasi që për pajisje të TI mund të ofrohet gjithmonë specifikim i detajuar teknik. Prandaj, në asnjë rast nuk ka pasur lëshim në FPO (DT) sikurse AK ka pretenduar në Vendimin e tyre për anulim. Këtë pikërisht e vërteton edhe fakti se duke e bazuar ankesën tonë në këto pika të LPP, RRPP dhe Udhëzuesin, PSH i OSHP në ankesën nr. 2023/0482 e ka marrë plotësisht si të bazuar ankesën tonë dhe ka ri konfirmuar se OE i propozuar për kontratë kompania Aritech është i papërgjegjshëm.”

Pretendimi i katërt (IV): “Rrjedhimisht, Vendimi i AK për anulim NUK ka bazë ligjore sepse nuk përmbush asnjërin nga kushtet e parapara me LPP – Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit. Arsyetimi 2 - Respektimi i Vendimit të OSHP-së nr. 2023/0482 nuk vlen sepse: 5. AK në Vendimin e tyre për anulim i referohet respektimit të vendimit të OSHP nr. 2023/0482 si arsye për anulim. Ky arsyetim është plotësisht i pabazuar pasi që OSHP me vendimin nr. 2023/0482 ka vendosur në dispozitiv të këtij vendimi që: “Ankesa të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.” Poashtu, OSHP në vendimin e tyre ka cekur se raporti i ekspertit shqyrtues, i cili ka pretenduar se: “AK ka bërë lëshime në FPO dhe ka rekomanduar për anulim të aktivitetit të prokurimit, NUK paraqet pasqyrim të gjendjes reale”. AK, në fakt nuk ka respektuar fare Vendimin e lartcekur të OSHP por e ka SHKELUR atë. Të njëjtin interpretim të gabuar e të qëllimshëm të vendimit të OSHP, AK e ka përdorur në Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, të datës 01.11.2023, duke shkelur kështu përsëri vendimin e juaj (OSHP).”

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 7, neni 28, neni 59, neni 62 i LPP-se si dhe pika 20, pika 41 e RRUOPP-së. Duke propozuar që OSHP të aprovoj të bazuar ankesën tonë si dhe të obligoj Autoritetin Kontraktues - Komuna e Gjakovës që të anuloj Njoftimin e Autoritetit Kontraktues mbi Ri-vendimin (Anulimin) të datës 25.10.2023 dhe lëndën ta kthej në rivlerësim.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: “Pretendimi juaj nuk qëndron, sepse Autoriteti kontraktues në Ftesën për ofertim, ka kërkuar vetëm deklaratë për specifikimet teknike, të cilën

Operatorët Ekonomik e kanë ofruar, mirëpo në Vendimin e OSHP-së,-2023/0482. Dt.02.10.2023, është thënë se Autoriteti kontraktues ka bërë lëshim se nuk ka kërkuar specifikime më detajuar ashtu siç ceket në Marrëveshjen kornizë të lidhur me AQP-në: Në përgjigje të pretendimit të OE ankues lidhur me këtë çështje, vlerësojmë se problemi ka të bëjë me lëshimin e bërë nga AK në FPO që është dërguar te OE-të. Konkretisht Kushtet e tenderit të përcaktuar në Nenin IV në FPO nuk pasqyrojnë kërkesat e Marrëveshjes Kornizë bazë, në të cilën specifikohet Shënim:- Te plotësohen me saktësi dhe qartësi kolonat në të djathtë "Specifikacioni teknik minimal i ofruar" "dhe secila informatë aty duhet të përputhet me katalogun të cilin e ofroni, pra gjithsecila informatë e plotësuar nga ju duhet të jete edhe në katalog që të mund të vërtetohet gjate vlerësimit. Ku kërkohet "minimumi" Ose "or better" ju duhet të shkruani saktë se çfarë ofertoni ndërsa kur kërkesa është e prere si p.sh "Mausi dhe tastieri: USB Mouse QWERTY Keyboard" ju mund plotësoni me ? ose x" Për secilin produkt duhet të specifikoni emrin e modelit që e ofroni.Ne kolonën e parë të secilit produkt tek - Prodhuesi - Brand Name dhe në kolonën e fundit duhet të shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të modelit të cilin e ofroni. Sistemi operativ i ofruar duhet të jete i licencuar. Tek laptopet duhet të ofronin çanta të cilat duhet të jenë të njëjtit prodhues e përfshirë në konfiguracion. Në një situatë të tillë AK duke mos specifikuar në FPO se dokumenti i specifikimeve teknike duhet të përfshijë edhe informatat për modelet dhe specifikimet e pajisjeve të ofertuar si dhe katalogun, si informata të cilat kërkohen nga kushtet e marrëveshjes bazë, ka lënë mundësinë që OE-të të ofertojnë pa dhënë informacion se me cilat produkte ofertojnë rrjedhimisht edhe krijon paqartësi në pranimin e pajisjeve duke e ditur që në procedurë konkretisht në kontratë nuk dihet se cili do të jetë modeli duhet të liferohet, përkatësisht pranohet. Në situatë të tillë, e vetmja rrugë për Autoritetin Kontraktues ka qenë anulimi i procedurës. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 23/11/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0899/23, ndërsa me datë 29/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 23/0899 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa AK ta anulojë aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertës shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar se Nuk Pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtuese.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Botek Sh.P.K” eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0899 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës : “Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, gjatë këtij aktiviteti ka zbatuar procedurën e mini-tenderëve përmes ftesës për ofertim, bazuar në kontratën publike kornizë me disa OE të lidhur nga AQP-ja, me titullin “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative”, sipas Kontratës Kornizë me numër UA/2016-19-9628-1-1-1/FA-153 e nënshkruar më datë 31.08.2020, e cila është vlefshme për dy vite. Ftesa për ofertim (FPO) është dërguar për OE-të e para kualifikuar më datë 22.05.2023, ndërsa afati për dorëzimin e ofertave ishte data 05.06.2023. Më datë 25.10.2023, AK ka publikuar njoftimin lidhur me vendimin, ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Pasi OE ankuese ishte e pakënaqur me vendimin e AK-së, më datë 26.10.2023 ka paraqitur një Kërkesë për Rishqyrtim te AK-ja dhe ka ngritur pretendime të njëjta si në ankesën aktuale. Më datë 01.11.2023, AK ka marrë një vendim lidhur me refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.”

Konstatimi i parë (I): “Për këtë aktivitet të prokurimit është nxjerrë edhe vendimi paraprak me nr.482/23 i dt. 02.10.2023, ku OE ankues thekson se në dispozitiv të këtij vendimi i është dhënë të drejtë pasi që i është aprovuar ankesa. Lidhur me vendimin e P.SH nr.482/23 te datës 02.10.2023, eksperti shqyrtues sqaron se Paneli Shqyrtues ka vendosur në pretendimin ankimor i cili ishte ngritur nga OE ankues, dhe vendimi i OSHP ka karakter obligativ për palët, ku dhe AK ka rivlerësuar AP. Ndërsa Eksperti Shqyrtues në raportin e ekspertizës ka theksuar se AK ka bërë një lëshim duke mos definuar saktë informatat për modelet dhe specifikimet e pajisjeve që do të ofertohen si dhe broshurë. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqaroj se parashtruesi i ankesës e konteston vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Në veçanti, OE ankues pretendon se OE i rekomanduar në vendimin e datës 22.06.2023 nuk ka dorëzuar një specifikim teknik të detajuar të pajisjeve të ofruara, ashtu siç kërkohet nga Marrëveshja Publike Kornizë, që është baza e Ftesës për Ofertim (FPO). Eksperti sqaron se Neni 28 i LPP-së për specifikimet teknike përcakton kornizën e veprimeve të AK-së për përcaktimin e specifikimeve teknike të lëndës së një aktiviteti të prokurimit dhe jo kriteret apo kërkesat për OE-të që duhet të dorëzojnë. Po ashtu, në FPO-në e publikuar AK nuk ka përcaktuar kërkesa për dorëzimin e dokumentit me specifikacionet teknike të produkteve të ofertuara, por është kërkuar b. Deklarata mbi Specifikimet Teknike të objektit të ofruar të kontratës, që korrespondon me ato të përmendura në Aneksin 1 të FPO-së. Pra formulimi i tillë i kërkesës nuk përcakton që duhet të dorëzohen specifikimet dhe modeli i ofertuar por pohim deklarativ i përmbushjes së specifikimeve sikurse të përcaktuara nga AK në aneksin 1 të FPO. Duke qenë kështu konform nenit 59 të LPP-së paragrafi 4 ku thuhet “AK do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, eksperti vlerëson se në mungesë të definimit të kërkesave për të përcaktuar ofertuesit produktin e ofertuar, mosdorëzimi i informacionit për modelet e ofertuara nuk mund të shërbejë si kriter për diskualifikimin e OE-ve, në të njëjtën kohë jep hapësirë për përzgjedhje të ofertuesit pa e ditur produktin e ofertuar, rrjedhimisht plotësimin e specifikimeve teknike minimale .Sikurse është sqaruar në raportin paraprak, vlerësoj se problemi ka të bëjë me lëshimin e bërë nga AK në FPO që është dërguar te OE-të. Konkretisht kushtet e tenderit të përcaktuar në

Nenin IV në FPO nuk pasqyrojnë kërkesat e Marrëveshjes Kornizë bazë, në të cilën specifikohet Në një situatë të tillë AK duke mos specifikuar në FPO se dokumenti i specifikimeve teknike duhet të përfshijë edhe informatat për modelet dhe specifikimet e pajisjeve të ofertuara si dhe broshurën, si informata të cilat kërkohej nga kushtet e marrëveshjes bazë, ka lënë mundësinë që OE-të të ofertojnë pa dhënë informacion se me cilat produkte ofertojnë rrjedhimisht edhe krijon paqartësi në pranimin e pajisjeve duke e ditur që në procedurë konkretisht në kontratë nuk dihet se cili do të jetë modeli që duhet të liferohet, përkatësisht pranohet. Eksperti shqyrtues sqaron se Marrëveshja kornizë ishte lidhur me AQP-në dhe mini tenderët duhet ti përmbahen nenin 54.40 të rregullores për prokurim publik me nr. 001/2022 Zhvillimi i procedurës (mini tenderimi) në rastet e aktiviteteve të prokurimit qendror të zhvilluar nga ana e Agjencinë Qendror të Prokurimit në emër të Autoriteteve të tjera kontraktuese duhet të zhvillohet nga vetë Autoriteti kontraktuese kurdo që lind nevoja. Ndërsa neni 54.41 parasheh që Mini-tenderimi duhet të jetë në bazë të “ kushteve të njëjta dhe nëse është e nevojshme sipas termeve të formuluar si dhe kurdo që është e përshtatshme termave të tjera të cilave ju referohet specifikimi në kontratën publike kornizë”. Kjo i nënshtrohet ndalimit (shmangie ose kufizime esenciale) prej termave të përcaktuar në kontratën publike kornizë. Eksperti shqyrtues sqaron se ky lëshim në FPO nga AK, është i pa-përmirësueshëm në këtë fazë. Në këtë kuptim eksperti vlerëson se nuk mund të detyrohet AK të diskualifikojë një OE për kritere të cilat nuk janë përcaktuar në FPO. Andaj rekomandohet të anulohet aktiviteti i prokurimit dhe nëse AK ka interes përsëri për iniciimi e mini tenderëve duhet të përgatit ftesë për ofertim me kritere të qarta dhe në përputhje me marrëveshje kornizë të nënshkruar nga AQP-ja.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Botek Sh.P.K” Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Botek Sh.P.K” janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashitjet e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se

të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues, pasi që dy herë radhazi përfshirë edhe raportin e ekspertizës NR: 2023/0482 të datës 26.07.2023, ku evidenton lëshimet që janë bërë me rastin e inicimit të kësaj procedure dhe për këtë mbetet përgjegjësi e ekspertit shqyrtues, ashtu sikurse është përgjegjësi edhe e komisionit të vlerësimit të ofertave konform nenin 59.1 të LPP, i cili ka propozuar anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ska si mos të veproj ndryshme përveç se të mbështetet në këto konstatime dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankues të kualifikohen si të pabazuara.

Andaj, paneli shqyrtues duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe vështirësinë e vendosjes meritorie në kontekstin e konstatimit të ndonjë nga OE si të përgjegjshëm dhe vendosja më e drejtë lidhur me këtë procedurë është të mbështet anulimi e saj dhe AK në rast se të njëjtnë e ka në plan ta ri-tenderoj atëherë të ketë kujdes në vendosjen e kriterëve si dhe në rast të ndonjë kërkesë e cila nuk është sqaruar mjaftueshëm atëherë gjitha palët që janë të interesuara të ofertojnë të kërkojnë edhe sqarime shtesë në fazën epara aplikimit në tender.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik. Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1,

sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Botek shpk**
- Arkivës së OSHP-së: